

Vendim nr. 64 datë 24.03.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Elsa Toska,	Kryesuese
Genti Ibrahim, i,	Anëtar
Ilir Toska,	Anëtar

në datën 24.03.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 1 (L) 2023 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: LULZIM SKRAQI

OBJEKTI: Shpallja e ligjit nr. 45/2015, ndryshuar me ligjin e datës 22.10.2022, dekretuar në datën 11.11.2022, botuar në Fletoren Zyrtare më 17.11.2022, si i papajtueshëm me Kushtetutën pjesërisht dhe kthimi i tij në parlament me emërtimin “Ligji i të vërtetës e pajtimit kombëtar” me plotësimin “Luftës së klasave” si gjenocid kundër shqiptarëve, të ushtruar nga Partia Komuniste shqiptare që ndërroi emrin në Parti e Punës në 1948 dhe në 1991 në Parti Socialiste, “me pasoja të rënda në evoluimin gjenetik të shqiptarëve”. Të urdhërohet parlamenti të plotësojë këtë ligj me a) autorët e gjenocidit (Byroja Politike e PPPSH-së, KQPPP-së); b) bashkëpunëtorët (ish-deputetët që miratuan ligjet e gjenocidit, funksionarët e shkollës së partisë që ndërtuan filozofinë e luftës së klasave në Shqipëri, anëtarë të byrove të partisë dhe komiteteve të partisë në rrethe), c) ekzekutorët (ministrat, drejtuesit e organizatave të masave, punonjësit e degëve të brendshme, prokurorët, hetuesit, gjykatësit punonjësit e sigurimit të shtetit të implikuar në këtë krim), d) të shfajësuarit (ish komunistët e thjeshtë, ish të dënuarit që bashkëpunuan në kushtet e dhunës e torturës).

BAZA LIGJORE: Nenet 29, pika 1, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 180, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 1 i Konventës së Hagës; Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në vitin 2015 Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar ligjin nr. 45/2015, datë 30.04.2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” (*ligji nr. 45/2015*). Sipas nenit 1 të tij, ligji ka për qëllim të përcaktojë rregullat dhe procedurat për të bërë të mundur ushtrimin e së drejtës nga çdo i interesuar për informimin mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, nëpërmjet një procesi demokratik dhe transparent, mbrojtjes së personalitetit të individit, si dhe unitetit e pajtimit kombëtar. Për realizimin e këtij qëllimi, në këtë ligj përcaktohen rregullat për: a) mbledhjen, administrimin, përpunimin dhe përdorimin e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë; b) organizimin dhe funksionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit; c) njohjen e personave me të dhënat e ruajtura nga ish-Sigurimi i Shtetit për ta; ç) vënien në dispozicion të institucioneve shtetërore dhe joshtetërore të informacioneve të domosdoshme për qëllimet e parashikuara në këtë ligj; d) detyrimet e autoriteteve publike dhe arkivave për vënien në dispozicion, për qëllime të zbatimit të këtij ligji, të dokumenteve të disponuara prej tyre. Kurse në nenin 2 është përcaktuar fusha e veprimit të këtij ligji.

2. Ky ligj është ndryshuar në vijim me ligjin nr. 114/2020, datë 29.07.2020, botuar në Fletoren nr. 154, datë 26.08.2020, dhe me ligjin nr. 72/2022, datë 20.10.2022, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 154, datë 17.11.2022.

3. Në datën 07.02.2023 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë për shpalljen si jokushtetues pjesërisht të ligjit nr. 45/2015, si edhe kthimin në Kuvend me qëllim plotësimin e tij, sipas objektit të kësaj kërkesë.

II

Pretendimet e kërkuesit

4. **Kërkuesi**, në mbështetje të kërkesës së tij drejtuar Gjykatës, ka parashtruar sa vijon:

4.1. *Për legjitimimin:*

4.1.1. Kërkuesi legjitimohet *ratione personae* si bartës i të drejtave themelore kushtetuese të cenuara nga ligji i kundërshtuar. Shpallja e luftës së klasave, një krim shtetëror 45-vjeçar i paramenduar për zhdukjen tërësisht ose pjesërisht të grupeve etnike, të klerikëve fetarë dhe të elitës së kombit, ka qenë një gjenocid i hapur me vendime të Byrosë Politike dhe të Komitetit Qendror të Partisë së Punës, i shprehur me ligjin e agjitacion propagandës, me pasojë pushkatimin, burgosjen, internimin e qytetarëve dhe të tradhtisë për kalim kufiri dhe izolim të plotë. Nuk janë respektuar të drejtat themelore të njeriut dhe është mohuar e shpërfillur e drejta për jetën, janë privuar grupe të tëra shoqërore nga mundësitë e jetës normale, duke qenë të dhunuar e nën terrorin fizik, psikologjik e të varfërisë, çka ka sjellë pasoja të rënda në deformimin e zhvillimit dhe evoluimit gjenetik të shqiptarëve.

4.2. *Pretendimet për shkeljet kushtetuese:*

4.2.1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 414, datë 24.05.1996, ka deklaruar fajtorë disa funksionarë të lartë të ish-Partisë së Punës për krime kundër njerëzimit dhe gjenocid, kurse Gjykata e Kasacionit, me vendimin nr. 344, datë 29.09.1999, ka vendosur pushimin e çështjes. Ky vendim nuk është në përputhje me Kushtetutën, pasi vepra penale e krimit shtetëror gjenocid ka ndodhur, por nuk është ndëshkuar dhe ligji nr. 45/2015 nuk i ndëshkon krimet shtetërore komuniste. Pushimi dhe lirimi i funksionarëve komunistë të dënuar në vitet 1991-1996 është bërë në kundërshtim me parimin e ndëshkimit të veprave penale të krimeve shtetërore (gjenocidit), pasi nuk ishin shteruar mjetet juridike, për shkak të objektit të gabuar të kërkuesve dhe mungesës së ligjit të

shpalljes së luftës së klasave si gjenocid, me bazë ligjore nenin 73 të Kodit Penal dhe Konventën e Hagës për gjenocidin.

- 4.2.2. Me ligjin nr. 45/2015 shkelet barazia para ligjit pasi nuk dënohen autorët, bashkëpunëtorët, ekzekutorët dhe nuk klasifikohen të shfajësuarit. Parlamenti dhe vendimet gjyqësore të sipërcituara nuk e kanë zgjidhur dënimin e krimeve komuniste dhe ato kanë mbetur të pandëshkuara, për shkak të mungesës së ligjit për shpalljen e luftës së klasave si gjenocid. Autorët, bashkëpunëtorët dhe ekzekutorët janë liruar, janë shpallur të pafajshëm dhe janë shpërblyer për izolimin, duke krijuar precedentin e mosndëshkrimit të krimet shtetëror, prandaj ai vazhdon edhe sot.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkesit

5. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) të subjekteve që vënë në lëvizje Gjykatën është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Bazuar në nenin 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e këtyre të drejtave. Kjo dispozitë kushtetuese është zbërthyer konkretisht në ligjin nr. 8577/2000, që i njeh individit të drejtën për të ushtruar ankim kushtetues individual për kundërshtimin e çdo akti që cenon të drejtat dhe liritë kushtetuese (neni 71), si dhe parashikon kriteret paraprake që duhet të përmbushen për paraqitjen e tij (neni 71/a). Sipas pikës 2 të nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, objekt i ankimit kushtetues individual, në raste të veçanta, mund të jetë edhe ligji ose akti normativ, nëse përmbushen kriteret e parashikuara nga neni 49, pika 3, shkronja “e”, i tij, të cilat lidhen me cenimin e drejtpërdrejtë dhe real të të drejtave dhe lirive kushtetuese, shterimin e të gjitha mjeteve juridike përkatëse dhe zbatueshmërinë e drejtpërdrejtë të aktit objekt ankimi, që do të thotë se për zbatimin e tij nuk është i nevojshëm miratimi i akteve nënligjore.

6. Bazuar në përmbajtjen e normës kushtetuese dhe të normave ligjore, Gjykata ka theksuar se kur objekt i ankimit kushtetues individual është një ligj ose një akt normativ, kërkesi legjitimohet nëse plotësohen bashkërisht këto kriteret: provon se është bartës i së drejtës

kushtetuese të pretenduar të cenuar (*ratione personae*); ka shteruar mjetet juridike efektive për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar ose provon se akti i kundërshtuar është drejtpërdrejt i zbatueshëm; ka paraqitur ankim brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit (*ratione temporis*); provon interesin në lidhje me çështjen, pra cenimin e drejtpërdrejtë dhe real të së drejtës kushtetuese (*ratione materia*) (shih vendimin nr. 31, datë 04.10.2021 të Gjykatës Kushtetuese).

7. Duke analizuar kriteret sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe nenit 49, pika 3, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577/2000, Kolegji vëren se kërkuesi duhet të provojë se ka pësuar cenim të të drejtave të tij themelore, pra që është viktimë e një shkeljeje, në kuptimin që akti i kundërshtuar ka prekur situatën e tij juridike në mënyrë të drejtpërdrejtë, reale dhe individuale. Në këtë drejtim, dispozitat e lartpërmendura, të cilat parashikojnë ushtrimin e ankimit kushtetues individual, nënkuptojnë se individi mund të bëjë kërkesë vetëm për çështje që janë drejtpërdrejt të zbatueshme ndaj tij, pra që lidhen me interesat e tij.

8. Kolegji vëren se në objektin e kërkesës drejtuar Gjykatës është kërkuar shfuqizimi pjesërisht i ligjit nr. 45/2015, i ndryshuar me ligjet nr. 114/2020 dhe nr. 72/2022, dhe kthimi i tij për plotësim në Kuvend, kurse në themel të kërkesës janë ngritur pretendime edhe në lidhje me një vendim të vitit 1999 të Gjykatës së Kasacionit (Gjykata e Lartë), që ka vendosur pushimin e çështjes penale për disa funksionarë të lartë të ish-Partisë së Punës, të cilët, sipas kërkuetit, ishin dënuar për krime kundër njerëzimit dhe gjenocid. Po sipas tij, ligji nr. 45/2015 dhe ky vendim gjyqësor kanë lënë pa ndëshkuar veprat penale të krimit shtetëror komunist (gjenocid).

9. Ligji nr. 45/2015 ka për qëllim të përcaktojë rregullat dhe procedurat për të bërë të mundur ushtrimin e së drejtës nga çdo i interesuar për informimin mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit nëpërmjet një procesi demokratik dhe transparent, mbrojtjes së personalitetit të individit, si dhe unitetit e pajtimit kombëtar (*neni 1*) dhe zbatohet për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë për periudhën 29 nëntor 1944 deri në ditën e krijimit të Shërbimit Informativ Kombëtar, 2 korrik 1991, të cilat disponohen nga të gjitha arkivat e rrjetit arkivor të Republikës së Shqipërisë dhe lidhen kryesisht, por pa u kufizuar, me veprat penale politike të parashikuara në ligjin nr. 7514, datë 30.9.1991 “Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë”, të ndryshuar, pavarësisht nëse është dhënë ose jo një dënim për këto vepra nga organet kompetente të regjimit komunist (*neni 2*).

10. Bazuar në sa më sipër, si dhe referuar pretendimeve të parashtruara nga kërkuesi, Kolegji vëren se ai nuk ka arritur të identifikojë të drejtën kushtetuese që synon të mbrojë nëpërmjet këtij ankimi kushtetues individual. Po kështu, kërkuesi nuk ka arritur të provojë se ligji i kundërshtuar është drejtpërdrejt i zbatueshëm ndaj tij dhe se në ç`mënyrë dispozitat e tij e kanë cenuar në të drejtat kushtetuese ose e kanë penguar në ushtrimin e tyre. Pretendimet e kërkuesit kanë karakter të përgjithshëm dhe nisen nga konsiderata personale, ndërkohë që ai nuk ka arritur të evidentojë as parimet ose të drejtat kushtetuese që cenohen/preken nga emërtimi dhe përmbajtja e ligjit të kundërshtuar.

8. Neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës nuk parashikon të drejtën e paraqitjes së një *actio popularis* dhe nuk lejon që individët të kundërshtojnë një akt të pushtetit publik pa qenë të prekur drejtpërdrejt prej tij, pra vetëm sepse e konsiderojnë si të papajtueshëm me Kushtetutën. Në këtë kuptim, Kolegji vlerëson, gjithashtu, se kërkuesi nuk mund t’i drejtohet kësaj Gjykate në mënyrë të drejtpërdrejtë për kundërshtimin e ligjit objekt kërkese, por ai duhet të paraqesë një akt individual negativ (ose ndalues) të dalë në zbatim të këtij ligji, nga i cili t’i ketë ardhur një pasojë negative konkrete, që duhet ta kundërshtojë gjyqësisht bashkë me dispozitat ligjore që i konsideron të papajtueshme me Kushtetutën.

9. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk ka arritur të provojë interesin e tij të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues, ndaj ai nuk legjitimohet t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual. Mungesa e legjitimitetit të kërkuesit e bën të panevojshme analizën e mëtejshme për përmbushjen e kriterëve të tjera rreth ankimit kushtetues individual të tij.

10. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.